



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05
Prokurori kundër Salih Mustafës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore Dr. Fidelma Donlon

Data: 5 janar 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për Parashtrime lidhur me Rishikimin e Paraburgimit

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të të Akuzuarit
Juilus von Bóné

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ sipas nenit 41(10) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe Provave përpara Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 12 qershor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi Aktakuzën kundër Salih Mustafës ("z. Mustafa"),² dhe lëshoi një urdhër për arrestimin e tij³ bashkë me një urdhër për transferimin e tij në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS").⁴

2. Më 24 shtator 2020, z. Mustafa u arrestua dhe u transferua në objektin e paraburgimit të DHS-së në Hagë, Holandë.⁵

3. Më 23 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi vendimin e tij të parë mbi rishikimin e paraburgimit të z. Mustafa.⁶

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Sipas nenit 41(10) të Ligjit, deri sa aktvendimi të marrë formë të prerë ose deri në lirim, me kalimin e dy muajve që nga vendimi i fundit për paraburgimin, Gjykatësi i

¹ KSC-BC-2020-05, F00001, Kryetari, *Vendim për Caktimin e gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-05, F00008/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Salih Mustafës*, 5 tetor 2020, publik.

³ KSC-BC-2020-05, F00009/A01/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i fletarrestimit për z. Salih Mustafë*, 12 qershor 2020, publik.

⁴ KSC-BC-2020-05, F00009/A02/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Urdhrit për Transferim në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 12 qershor 2020, publik.

⁵ KSC-BC-2020-05, F00013, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 24 shtator 2020, publik; F00014, Administratorja, *Njoftim i Pranimit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁶ KSC-BC-2020-05, F00052, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 23 nëntor 2020, publik.

Procedurës Paraprake i ngarkuar me çështjen shqyrton nëse arsyet e paraburgimit vazhdojnë të ekzistojnë ende dhe jep një vendim me anë të të cilit paraburgimi ose zgjatet ose përfundon.

5. Sipas rregullës 57(2) të Rregullores, pas caktimit të një Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe deri sa aktgjykimi të marrë formë të prerë, Paneli që merret me çështjen rishikon vendimin mbi paraburgimin pasi të përfundojnë dy muaj që nga vendimi i fundit për të, në pajtim me nenin 41(6), (10), (11) dhe (12) të Ligjit ose në çdo kohë me kërkesën e të akuzuarit apo të Prokurorit të Specializuar, ose *proprio motu*, kur ka ndodhur një ndryshim në rrethanat e çështjes që nga rishikimi i fundit.

III. DISKUTIM

6. Në dritën e vendimit të fundit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi paraburgimin, të datës 23 nëntor 2020 dhe në pajtim me nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores, rishikimi tjetër i paraburgimit të z. Mustafa duhet të bëhet me përfundimin e dy muajve që nga vendimi i fundit mbi paraburgimin.

7. Përpara se të nxjerrë një vendim *proprio motu* mbi rishikimin e paraburgimit të z. Mustafa, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrton parashtrimet e palëve për këtë çështje.

IV. VENDIMI

8. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake me anë të këtij urdhri:

- a. **KËRKON** nga ZPS-ja të paraqesë parashtrime me shkrim deri të **mërkurën, 13 janar 2021**, nëse vazhdojnë të ekzistojnë arsyet për vijimin e paraburgimit të z. Mustafa, ose nëse paraburgimi i tij duhet të përfundohet; dhe

- b. **KËRKON** nga Mbrojtja të dorëzojë parashtrime me shkrim deri të **hënën, 18 janar 2021**, nëse arsyet për vijimin e paraburgimit të z. Mustafa vazhdojnë të ekzistojnë, ose nëse paraburgimi i tij duhet të përfundohet.

/nënshkrimi/

Gjykatësi Nikola Giju
Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E martë, 5 janar 2021
Hagë, Holandë